

DESCRIPTIVE ASSESSMENT FROM CLASS IV TO CLASS VI UNDER PANDEMIC CONDITIONS

Rabije Osmani

Municipal primary school "Mehmet Deralla" - Municipality of Vrapçishti-p. Gradec, Republic of North Macedonia, rabije.osmani@unite.edu.mk

Rabije Murati

University of Tetovo- Tetovo, Republic of North Macedonia, rabije.murati@unite.edu.mk

Abstract: The time of the pandemic subjected the world education system to a life-threatening challenge, an experience that the Republic of North Macedonia could not avoid. The prevention of COVID-19 dictated the temporary closure of educational institutions at all levels. The pandemic imposed a reorganization of the education system in general since in addition to the system, it also encountered all the subjects who were not prepared and had no prior experience with distance learning, which made the end of the relevant school year to be left at the mercy of the individual circumstances of the teachers. However, the beginning of the 2020-2021 school year revealed facts about the system in different approaches and preparation for a new beginning. Since the majority of teachers declared a lack of skill in manipulating technology equipment, all teachers were trained in the use of educational platforms specially prepared for distance learning. The platform offered at the national level proved to be accessible for manipulation by any teacher regardless of the level of prior knowledge of the teachers. Although with a lot of skepticism, after adopting the primary manipulation of the platform, the teachers shared their concern about the objective and realistic assessment of the student's achievements, the forms, methods, and measurements that had to be realized during distance learning as well.

Descriptive assessment should be suggestive, provide feedback, be comprehensible and clear, simple, transparent, short, stimulate curiosity, continuous and economical. The same should include all formal and informal means, and all methods of marking or evaluation should be used to expand official information between the relevant factors teachers, students, and parents, with which the differences in the effect of the implementation of the same are examined. The descriptive assessment with its characteristics provides relevant data for creating a descriptive summative grade. It is in this paper that the level of realization of descriptive assessment in times of pandemic will be elaborated as a form of assessment and its basic characteristics as a process, as well as the way of implementation in practice. This research also aims to investigate the attitudes of teachers regarding descriptive assessment during distance learning. The real examination of the problem will be elaborated by answering the questions that are oriented to give an overview of the following issues: the attitudes and experience of teachers regarding the assessment of student achievements during distance learning, the formation of portfolios from the teacher as a tool to help and prove the achievements of the students for distance assessment, as well as the eventual difficulties during the assessment and the opinions of the teachers about the feedback information of the assessments they have applied. The collected results will be presented through statistical methods to give a clear and real overview of the real experience of the process of descriptive assessment of student achievement during distance learning.

Keywords: descriptive assessment, distance learning, portfolio, online distance assessment

VLERËSIMI PËRSHKRUES NGA KLASA E IV DERI NË KLASËN E VI NË KUSHTE PANDEMIE

Rabije Osmani

Shkolla fillore komunale: " Mehmet Deralla" - Komuna e Vrapçishtit-f. Gradec, Republika e Maqedonis së Veriut, rabije.osmani@unite.edu.mk

Rabije Murati

"Universiteti i Tetovës"- Tetovë, Republika e Maqedonis së Veriut, rabije.murati@unite.edu.mk

Koha e pandemisë nënshtrij sistemin arsimor botëror në sfidë të pajetuar, përvojë të cilës nuk mund arriti ti shmanget e dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Parandalimi i COVID-19 diktoi mbylljen e përkohshme të institucioneve arsimore të të gjithë niveleve. Pandemia imponoi riorganizim të sistemit arsimor në përgjithësi, me qenë se përpos sistemit, hasi edhe të gjithë subjektet të pa përgatitur dhe pa eksperiencë paraprake me mësim në distancë, e cila bëri që përfundimi i vitit përkatës shkollor ti lehet në mëshirën e gjindshmërisë individuale të

mësimdhënësve. Mirëpo, fillimi i vitit shkollor 2020-2021 evidentoi fakte lidhur sistemit në qasje të ndryshme dhe përgatitje për fillim të ri. Duke qenë se numri më i madh i mësimdhënësve deklaroi mungesë të shkathtësisë për manipulim me pajisje të teknologjisë, të gjithë mësimdhënësit u trajnuan për përdorimin e platformave arsimore të përgatitura enkas për mësim në distancë. Platforma e ofruar në nivel nacional u dëshmuar si e qasshme për manipulim të çdo mësimdhënësi pa marrë parasysh nivelin e diturive paraprake të mësimdhënësve. Edhe pse me shumë skepticizëm, pasi përvetësuan manipulimin primar të platformës, mësimdhënësit ndanin shqetësimin lidhur vlerësimin objektiv dhe real të të arriturave të nxënësve, format, metodat e matjet që duhej të realizohen gjithashtu gjatë mësimin në distancë.

Vlerësimi përshkrues duhet të jetë sugjerues, të ofrojë informatë kthyesë, duhet të jetë i kuptueshëm dhe i qartë, i thjeshtë, transparent, i shkurtër, të nxisë kureshtje, i vazhdueshëm dhe ekonomik. I njëjti duhet të përfshin të gjithë mjetet formale dhe joformale, të gjitha mënyrat e notimit apo vlerësimit duhet të shfrytëzohen për zgjerim të informatave oficiale ndërmjet faktorëve relevant mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, me çka shqyrtohen dallimet në efektin e zbatimit të të njëjtave. Vlerësimi përshkrues me karakteristikat e saja jep të dhëna relevante për krijim të notës përshkruese sumative. Pikërisht në këtë punim do të shtjellohet niveli i realizimit të vlerësimit përshkrues në kohë pandemie si formë e vlerësimit dhe karakteristikat themelore të tij si proces, si dhe mënyra e zbatimit në praktikë. Ky hulumtim ka për qëllim gjithashtu të hulumtoj qëndrimet e arsimtarëve lidhur vlerësimit përshkrues gjatë realizimit të mësimin në distancë. Ekzaminimi real i problemit në fjalë do të shtjellohet me anë të përgjigjes së pyetjeve të shtruara të cilët janë orientuar të japin pasqyrë çështjeve si më poshtë: qëndrimet dhe përvoja e arsimtarëve rreth vlerësimit të të arriturave të nxënësve gjatë mësimin në distancë, formimi i portfolies nga ana e arsimtarëve si mjet për të ndihmuar dhe dëshmuar të arriturat e nxënësve për vlerësimi në distancë, si dhe vështirësitë eventuale gjatë realizimit të vlerësimit dhe mendimet e mësimdhënësve rreth informatave kthyesë të vlerësimeve të cilët kanë aplikuar. Rezultatet e grumbulluara do të paraqiten përmes metodave statistikore që të jepet pasqyrë e qartë dhe reale e përvojës reale të procesit të vlerësimit përshkrues të të arriturave të nxënësve në kohë të mësimin në distancë.

Fjalë kyçe: vlerësim përshkrues, mësimi në distancë, portofolia, vlerësimi online-në distancë

1. HYRJJA

Vlerësimi përshkrues në sistemin e verifikimit të të arriturave të nxënësve është komponent integrale e sistemit arsimorë dhe i shërben atij që ti arrije qëllimet edukativo-arsimore. Në bazë të punimit konkretisht të këtij hulumtimi subjektet e përfshirë japin të dhëna, sugjerime, shumica prej tyre kanë qëndrime plotësisht të drejta dhe të arsyeshme.

Vlerësimi, si segment i rëndësishëm i këtij sistemi duhet të përcillet në çdo hap të veprimtarisë didaktiko-mësimore, prandaj vlerësimi përshkrues është më efektiv sepse gjatë çdo ore mësimore mësimdhënësit duhet të vlerësojnë nxënësit dhe ato rregullisht duhet të shënojnë në ditarin personal (elektronike) të tyre për të ditur, se sa nxënësit e kanë aftësuar materialin apo temat e zhvilluara, sa ka qenë vetë arsimtari i suksesshëm në realizimin e qëllimeve të planifikuara më parë me një fjalë e vetëvlerëson punën e tij dhe njëkohësisht i korrigjon lëshimet e bëra.

Duke patur parasysh ndërlikueshmërinë që paraqet përcjella, vlerësimi i diturive, aftësive, shkathtësive dhe shprehive, gjithashtu njëkohësisht duke patur parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilën zhvillohet procesi mësimor në kohë pandemie, duhet të kemi mirëkuptim edhe ndaj gjendjes faktike të funksionimit të vlerësimit dhe notimit në përgjithësi si proces.

Duke u bazuar në faktet se rezultatet e këtij hulumtimi empirik treguan se ka qëndrime të ndryshme mbi realizimin e vlerësimit përshkrues në distancë, por vlerësimi objektiv nuk duhet të shikojmë edhe aq me sy kritik, nuk duhet të jemi aq pesimist edhe pse viteve të fundit bëhen përpjekje të mëdha për reforma dhe inovacioneve pozitive në procesin e vlerësimit të nxënësve por koha e pandemisë e lëvizti edhe më shumë aktivitetin e vlerësimit, pasi arsimtarët duhet të aftësoheshin për vlerësim permanent dhe të komentuar me anë të platformës, pasi informatat kthyesë janë aq të rëndësishme për të dy palët si për arsimtarin ashtu edhe për nxënësit.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

“Vlerësimi përshkrues”

Fëmijëve u kemi borxh një edukim më të mirë që të bëhen qytetarë të shoqërisë së dijes dhe nëse nuk do ta realizojmë, nuk do të na e falin (Musai, 2020:86). Mësimi bashkëkohorë kërkon mësimdhënësit që do të arrijnë të inkurajojnë nxënësit e tyre në gjenerimin e energjisë pozitive drejt rezultateve pozitive (Ismaili, 2019:53). Vetë akti i të vlerësuarit të njohurive të nxënësve nga ana e arsimtarit paraqet një motiv shumë të fortë. Notat, para së gjithash janë një lloj katalizatori pedagogjik-motiv për mësim. Nota është shprehje e shkallës së njohurive të nxënësve. Nota (dhe notimi, dhe vlerësimi i njohurive) do të bëhet motiv serioz për mësimin vetëm me kusht që të jetë e realit dhe objektivist ta shprehë shkallën dhe cilësinë e njohurive. Nxënësit mundohen që të mësojnë (përvetësojnë njohuri)

dhe paralel me këtë të marrë notë të mirë (vlerësim të lartë)! (Murati,2022:99). Nota përfundimtare e sintetizuar nga deklaratat, gjykimet, mendimet, karakteristikat vlerësuese të të arriturave të nxënësve përgjatë vitit shkollor është edhe nota oficiale për çdo nxënës. Nota këtu është dedikuar nxënësve, prindërve të tyre dhe arsimtarit i cili do ta pranonte nxënësin në vitin e ardhshëm vijues. Kjo notë është e regjistruar edhe në dokumentacionet pedagogjike në shkollë dhe me të rregullohet përparimi i nxënësve në klasat më të larta, me fjalë të tjera notat e këtu janë të shënuara në dëftesat që nxënësit i marrin në fund të vitit shkollor (Murati,2019:124). Vlerësimi përshkrues ka edhe karakteristikat e saja për notë të mirë përshkruese sumative. Ajo duhet të jetë: e thjeshtë, transparente, e shkurtër, të nxisë kureshtje, e vazhdueshme, të jetë e shkruar me kompjuter, të mos përmbajë informata të panevojshme dhe të paqarta. Zbatimi praktik i klasave të përmendura më lartë për vlerësim analitikë përshkrues realizohet me aktivitete adekuate, të strukturuar në elemente vijuese të konceptit (Osmani, 2017:44). Që nota përfundimtare përshkruese të mund t'i plotësojë të gjitha funksionet e veta (informative, motivuese, administrative) është e domosdoshme që të plotësojë edhe këto kërkesa: Të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme..., Të ketë qartësi... Të mos përmbajë informacione të panevojshme dhe të paqarta..., Të ketë orientim pozitiv..., Teknikisht të jetë mirë e rregulluar (Osmani,2017:61). Vlerësimi është procedurë që përdoret për të marrë informacione rreth performancës apo demonstrimit të nxënësve. Ai përbën një vlerë gjykimi mbi rezultatet e matura dhe interpretimin e të dhënave nga informacioni i grumbulluar. (Musai, 2017:60). Ka mundësi që vlerësimet në bazë të normës do të shënojnë rënje, teksa llogaridhënia do të përqendrohet më shumë në atë që faktikisht nxënësi di dhe mund të bëjë. Vlerësimi i performancës ka mundësi të marrë më shumë rëndësi, si gjatë punës në klasë, ashtu edhe në testet/provimet me rëndësi vendimtare. Vlerësimi elektronik do të integrohet në procesin arsimor, së bashku me ofrimin e mësimdhënies nëpërmjet internetit (Marsh, 2009:90).

„Të arriturat e nxënësve në ciklin në ciklin e dytë“

Nocioni vlerësim përshkrues i të arriturave të nxënësve nga klasa e parë deri në klasat e gjashta, ka strukturë adekuate pedagogjike dhe dokimologjike e cila garanton përcjellje të vazhdueshme, analitike, kontrollim dhe notim (vlerësim) të përparimit të nxënësve në mënyrë permanente në procesin edukativo_arsimor dhe që e nxitë zhvillimin e mëtutjeshëm të nxënësve. Vlerësimi i të arriturave në klasë të I deri VI-tën realizohet :

- Të arriturat e nxënësve në procesin edukativo_arsimor përcillen pandërprerë, kontrollohen dhe vlerësohen me përshkrim, se sa nxënësit i kanë përvetësuar qëllimet mësimore, në vend të notave numerike,
- Gjatë vitit mësimor, për të arriturat mbahen përshkrime (shënime) dhe për to jepen komente rrjedhëse (gojarisht ose me shkrim),
- Periodikisht në fund të tremujorëve dhe të gjysmëvitit të parë formohen vlerësime mikrosumative (sinetike)
- Në fund të vitit shkollor në klasën I, II, dhe III shkruhet të arriturat përfundimtare sumative për të arriturat gjatë vitit shkollor, ndërsa nga klasa e IV deri VI-të merren dëftesa me vlerësim numerik,

Vlerësimin përshkrues arsimtarët e realizojnë në mënyra të ndryshme të përditshme fjalë dhe me shenja, varësisht nga qëllimi që duhet të arrihen. Vlerësimi i të arriturave nga klasa e IV deri në klasë të VI të nxënësve bëhet në këtë mënyrë: _Në ciklin e dytë të shkollimit, notimi i nxënësve bëhet në dy lloje të notimit ,prej klasës së IV deri në të VI, nxënësit në tremujorin e parë dhe të tretë vlerësohen me vlerësim përshkrues, ndërsa pas tremujorit të parë deri në gjysëmvetorë, nxënësit notohen me notim numerik dhe gjithashtu pas tremujorit të tretë deri në fund të vitit nxënësit notohen me notim numerik. Dëftesat në fund të vitit janë me nota për arritjet e tyre.

Llojet e notimit përshkrues janë : notimi diagnostiko, notimi formativ, notimi sumativ dhe përfundimtare (sumative) përshkruese.

3. METODOLOGJIA

Lënda e kërkimit në këtë hulumtim është analiza e vlerësimit përshkrues nga klasa e 4 deri në të 6 në kohë pandemie, i cili ka rëndësi të veçantë edhe pse për arsimtarët ishte mbingarkesë duke realizuar vlerësim deskriptiv. Qëllimi parësor i këtij hulumtimi është të përcaktohet mbështetja, mbingarkimin, efikasiteti i vlerësimit në distancë të të arriturave të nxënësve në kohë të Covid-19. Ekzaminimi real i problemit në fjalë do të shtjellohet me anë të përgjigjes së pyetjeve të shtrura të cilët janë orientuar të japin pasqyrë çështjeve si më poshtë:

1. Qëndrimet dhe përvoja e arsimtarëve rreth vlerësimit të të arriturave nxënësve gjatë mësimimit në distancë;
2. Formimi i portfolies nga ana e arsimtarëve si mjet për të ndihmuar dhe dëshmuar të arriturat e nxënësve për vlerësimi në distancë;
3. Vështirësitë eventuale gjatë realizimit të vlerësimit, dhe
4. Mendimet e mësimdhënësve rreth informatave kthyesë të vlerësimeve të cilët kanë aplikuar.

Duke u mbështetur në vërtetimin e temës që do të hulumtojmë parashtrohet kjo hipotezë gjenerale :

H. Ekzistojnë dallime në qëndrimin e arsimtarëve në realizimin e vlerësimit përshkrues gjatë realizimit të mësimimit në distancë. Në bazë të hipotezës gjenerale dalin këto hipoteza ndihmëse: H1. Arsimtarët reagojnë rreth vlerësimit përshkrues gjatë mësimimit në distancë;

H2. Mësimdhënësit refuzojnë vlerësimin deskriptiv për shkak të mbingarkesës që jetojnë gjatë kësaj periudhe; H3. Portfolija fizike që shërben për grumbullimin e dëshmive nga vlerësimi formativ, u shëndrua në portfolio elektronike. H4. Gjatë realizimit të mësimin në distancë, mësimdhënësit kryesisht japin informata kthyesë në formë të shkruar. Për të arritur deri te qëllimi i hulumtimit do të realizojmë anketën me mësimdhënësit të arsimit fillor me anë të së cilës do të marrim mendime, ide, sugjerime për vlerësimin përshkrues nga klasa e 4 deri në të 6 në kohë pandemie. Me qëllim të zbardhjes së kësaj veprimtarie pedagogjike shtjellimi i çështjeve është orientuar sipas të dhënave relevante të grumbulluara nga pyetësorët anonim të mësimdhënëseve të përfshirë në proces. Kërkimi në fjalë përfshin 50 mësimdhënësit, qëndrimi i të cilëve u morr nëpërmjet të pyetësorit anonim i shtruar online. Me qëllim të verifikimit të supozimeve, të dhënave të grumbulluara iu qasemi me metoda statistikore të paraqitura si më poshtë.


4. REZUTATE

Nga pyetja e 1: A mendoni se vlerësimi përshkrues në kohë të pandemisë rezulton si efektiv? Pyetja e 2: A mendoni se ky lloj vlerësimi mundëson komunikimin e rezultateve të nxënësve në formën më të mirë të mundshme? Kemi arritur në këto rezultate:

Graf nr.1 Vlerësimi përshkrues në kohë të pandemisë rezulton si efektiv.




Graf nr.2 Vlerësimi përshkrues mundëson komunikimin e rezultateve të nxënësve në formën më të mirë të mundshme.



Vlerësimi përshkrues në kohë pandemie rezulton si pozitiv, sipas mësimdhënëseve 12% po, 6 % shpesh, 44% ndonjëherë, 18% rrallë, 20% asnjëherë. Nga rezultate dhe qëndrimet e mësimdhënëseve mund të konstatojmë se vlerësimi përshkrues në kohë të pandemisë rezulton ndonjëherë si efektiv. Nga graf.2 vlerësimi përshkrues mundëson komunikimin e rezultateve të nxënësve në formën më të mirë të mundshme, sipas mësimdhënëseve 13% po, 10 % shpesh, 35% ndonjëherë, 10% rrallë dhe 15 % asnjëherë. Nga rezultate e mësimdhënëseve mund të konstatojmë se vlerësimi përshkrues ndonjëherë mundëson komunikimin e rezultateve të nxënësve në formën më të mirë të mundshme.

Pyetje e 3: A mendoni se ky lloj i vlerësimit përfshin të arriturat dhe vështirësitë eventuale të hasura të nxënësve përgjatë këtij viti shkollor të realizuar në kohë të pandemisë? Pyetjen 4:A mendoni se ky lloj vlerësimi u merr shumë kohë?

Graf.3 Vlerësimit përfshin të arriturat dhe vështirësitë



eventuale

Graf. 4 Vlerësimi përshkrues merr kohë



Vlerësimi përshkrues përfshin të arriturat dhe vështirësitë eventuale të hasura tek nxënësit përgjatë këtij viti shkollor të realizuar në kohë të pandemisë, 17 % pohojnë se, 15 % shpesh, 28 % mendojnë se ndonjëherë, 17 % mendojnë se rrallë dhe 6 % mendojnë se asnjëherë ky lloj i vlerësimit përfshin të arriturat dhe vështirësitë eventuale të hasura të nxënësve përgjatë këtij viti shkollor të realizuar në kohë të pandemisë. Nga rezultate e mësimdhënëseve mund të konstatojmë se ndonjëherë vlerësimi përshkrues përfshin të arriturat dhe vështirësitë eventuale të hasura të nxënësve përgjatë këtij viti shkollor të realizuar në kohë të pandemisë. Për realizimin e vlerësimit përshkrues

arsimtarët se ky lloj vlerësimi u merr shumë kohë , 51% po, 15% shpesh, 10% ndonjëherë, 7% rrallë, 2 % asnjëherë. Frekuenca e qëndrimeve të mësimitdhënësve e përpunuar me histogram në të cilën shfaqet lakorja pozitive, edhe atë me 1.72 dhe devijimi i lartë standard, 1.089, lejon të përfundojmë se mësimitdhënësit shprehin mendimin se ky lloj vlerësimi u merr shumë kohë.


Pyetjen 5: A mendoni se vlerësimi deskriptiv rezulton në lodhje psiko-fizike të mësimitdhënësit?

Pyetja e 6: A keni dëshmi të instrumenteve të ndryshme për vlerësim të të arriturave, punimeve, shkrimeve, etj., të ruajtura në formë elektronik?

Graf.5 Vlerësimi deskriptiv rezulton në lodhje psiko-fizike të mësimitdhënësit




Graf.6 Dëshmitë e arsimtarëve për realizimin e vlerësimit përshkrues




Vlerësimi deskriptiv rezulton në lodhje psiko-fizike të mësimitdhënësit, nga hulumtimi mund të konstatojmë se 54 % po, 12 % ndonjëherë, 2 % rrallë dhe 2 % asnjëherë. Frekuenca e qëndrimeve të mësimitdhënësve e përpunuar me histogram në të cilën shfaqet lakorja pozitive, edhe atë me 1.68 dhe devijimi i lartë standard, 0.913, lejon të përfundojmë se vlerësimi deskriptiv rezulton në lodhje psiko-fizike të mësimitdhënësit. Në bazë të frekuencave të paraqitura në histogramin në grafikonin 6 të qëndrimeve të mësimitdhënësve ku shfaqet lakorja pozitive, edhe atë me 1.7 dhe devijimi i lartë standard, 0.909, lejon të përfundojmë mund të konstatojmë se arsimtarët kanë dëshmi të instrumenteve të ndryshme për vlerësim të të arriturave, punimeve, shkrimeve, etj., të ruajtura në formë elektronik.

Pyetjen 7 dhe 8: Sa u ndihmon portofolioja elektronike për realizim të vlerësimit mikrosumativ dhe sumativ? A keni kërkuar nga nxënësit të realizojnë e-portfolio personale për lëndën (ët) të cilën e ligjëroni me të cilën do të mundësoheshte vetëvlerësimi?

Graf.7 Portofolioja elektronike u ndihmon arsimtarëve për realizim të vlerësimit mikrosumativ dhe sumativ



Graf.8 Nxënësit mundohen të realizojnë e-portfolio personale për lëndën (ët) që mësojnë të cilat u mundësojnë vetëvlerësim



Portofolioja elektronike u ndihmon për realizim të vlerësimit mikrosumativ dhe sumativ, qëndrimet e mësimitdhënësve janë si vijon, 16 % po, 42 % shpesh, 30 % ndonjëherë, 10 % rrallë, 2% asnjëherë. Nga rezultate e mësimitdhënësve mund të konstatojmë se arsimtarëve shpesh portofolioja elektronike u ndihmon për realizim të vlerësimit mikrosumativ dhe sumativ. Nxënësit realizojnë e-portfolio personale për lëndën (ët) të cilën e ligjërojnë me të cilën do të mundësohet vetëvlerësim, qëndrimet e mësimitdhënësve janë si vijon konstatojmë 52 % po, 48 % jo. Nga rezultate e mësimitdhënësve mund të konstatojmë se arsimtarëve u kenë kërkuar nxënësve të realizojnë e-portfolio personale për lëndën (ët) të cilën e ligjërojnë me të cilën do të mundësohet vetëvlerësim.

Pyetja e 9 dhe 10: A jepni informacione kthyesë në formë të shkruar në platformat që përdorni gjatë mësimi online?
Sa ndikojnë informatat kthyesë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të nxënësve?

	A jepni informacione kthyesë në formë të shkruar në platformat që përdorni gjatë mësimi online?	Sa ndikojnë informatat kthyesë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të nxënësve?
A jepni informacione kthyesë në formë të shkruar në platformat që përdorni gjatë mësimi online?	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.824** .000 50
Sa ndikojnë informatat kthyesë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të nxënësve?	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.824** .000 50

Correlations

**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Sipas rezultateve të grumbulluara nga mësimdhënësit në bazë të korrelacionit të Pirsonit, duket qartë korrelacion i lartë, edhe atë prej 0.824. Korrelacioni në fjalë na lejon të mund të konstatojmë se me dhënjën e informatave kthyesë gjatë mësimi online, ka ndikuar në përmirësimin e performancës së përgjithshme të nxënësve.

5. DISKUTIM

Për verifikim të hipotezës së 1 të veçantë janë të analizuar rezultatet e fituara të pyetjeve 1, 2 dhe 3 nga pyetësi për arsimtarë. Të dhënat e fituara tregojnë se të anketuarit mendojnë se vlerësimi përshkrues në kohë të pandemisë rezulton ndonjëherë si efektiv, vlerësimi përshkrues ndonjëherë mundëson komunikimin e rezultateve të nxënësve në formën më të mirë të mundshme dhe se vlerësimi përshkrues ndonjëherë përfshin të arriturat dhe vështirësitë eventuale të hasura të nxënësve përgjatë këtij viti shkollor të realizuar në kohë të pandemisë. Këta informata apo rezultate shkojnë në favor të pohimit: "H1. Arsimitarët reagojnë rreth vlerësimit përshkrues gjatë mësimi në distancë. Me çka vërtetohet hipoteza 1. Për verifikim të hipotezës së 2 të veçantë janë të analizuar rezultatet e fituara të pyetjeve 4, 5 dhe 6 nga pyetësin për arsimtarë. Të dhënat e fituara tregojnë se të anketuarit mendojnë se vlerësimi përshkrues ju merr kohë arsimtarëve për realizimin e tij, vlerësimi deskriptiv rezulton në lodhje psikofizike të mësimdhënësit dhe se arsimtarët kanë dëshmi të instrumenteve të ndryshme për vlerësim të të arriturave, punimeve, shkrimeve, etj., të ruajtura në formë elektronik. Këta informata apo rezultate shkojnë në favor të pohimit: "H2. Mësimdhënësit refuzojnë vlerësimin deskriptiv për shkak të mbingarkesës së jetojnë gjatë kësaj periudhe". Me çka vërtetohet hipoteza 2. Për verifikim të hipotezës së 3 të veçantë janë të analizuar rezultatet e fituara të pyetjeve 7 dhe 8 nga pyetësin për arsimtarë. Të dhënat e fituara tregojnë se arsimtarëve shpesh portofolioja elektronike u ndihmon për realizim të vlerësimit mikrosomatik dhe sumativ dhe se arsimtarët u kenë kërkuar nxënësve të realizojnë e-portfolio personale për lëndën (ët) të cilën e ligjërojnë me të cilën do të mundësohet vetvlerësim. Me anë të këtyre të dhënave për hipotezën "H3. Portfolija fizike që shërben për grumbullimin e dëshmive nga vlerësimi formativ, u shëndrua në portfolio elektronike" kjo shkon në favor të hipotezës me çka edhe vërtetohet hipoteza 3. Për verifikim të hipotezës së 4 të veçantë janë të analizuar rezultatet e fituara të pyetjeve 9 dhe 10 nga pyetësin për arsimtarë.

Të dhënat e fituara tregojnë se arsimtarëve japin informacione kthyesë në formë të shkruar në platformat që përdorni gjatë mësimi online, si dhe informatat kthyesë ndikojnë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të nxënësve. Këta informata apo rezultate shkojnë në favor të pohimit: "H4. Gjatë realizimit të mësimi në distancë, mësimdhënësit kryesisht japin informata kthyesë në formë të shkruar". Me çka vërtetohet hipoteza 4. Verifiki i hipotezës gjenerale

Me verifikimin e të gjithë hipotezave të veçanta me çka vërtetohet edhe hipoteza gjenerale në këtë hulumtim e cila është: "H. Ekzistojnë dallime në qëndrimin e arsimtarëve në realizimin e vlerësimit përshkrues gjatë realizimit të mësimi në distancë".

LITERATURA

- Hayes, D. (2017). Bazat e mësimdhënies në arsimin fillor. Arbëria Design
Ismaili, H.B (2019). Roli i mësimdhënësit në mësimin tradicional dhe atë të inovuar. Arbëria Desing.
Kadriu, L.L. (2016). Komunikimi midis mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollë. Çabej
Liç, Xh., & Mum, B. (2016). Fuqia e pedagogjisë. Brano Gapo.
Marsh. C.J. (2009). Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin. Qendra për Arsim Demokratik

- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Republika e Kosovës. (2011). Standarde për tekstet shkollore.
- Musai, B. (2020). Arsimi në demokracinë e brishtë. Edualba.
- Murati, R. (2016). Demokratizimi i sistemit edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë. Arbëria Design.
- Murati, R. (2014). Metodika e punës edukative. Luma Grafik.
- Murati, R.. (2019). Mësuesi bashkëkohor dhe arsimi cilësor. Luma grafik.
- Murati,Xh..(2022).Fëmijët, nxënësit dhe fuqia e edukatës. Luma grafik
- Murati, Xh. dhe Tahiri C.A. (2017). Pedagogjia shkollore. Çabej.
- Muxhi, D. dhe Dejvid R. (2016). Mësimi i efektshëm dëshmi dhe praktikë. Branko Gapo.
- Osmani, R. (2017). Vlerësimi përshkrues i të arriturave të nxënësve të shkollës fillore, përparësitë dhe mangësitë. Teza e magjistraturës.
- Skrivener, Xh. (2016). Teknikat të menaxhimit të klasës. Branko Gapo.
- Zajazi, T. (2003). Metodologji të mesimdhenies dhe te mësimnxënies:(didaktika). Vinsent Grafika.
- USAID-Maqedoni, (2011),Notimi për mësim në shekullin 21, përmbledhje punimesh nga Konferenca ndërkombëtare, Ohër.